



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:049582

Datë: 27.02.2025

Numri i dokumentit: 06911739

KPPP.nr.1011/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbaremore të kreditorit KRU Bifurkacioni SH.A, me seli në Rr. “Enver Topalli”, në Ferizaj, me numër unik identifikues 910663353, kundër debitorit “Elegant” motel – K.M., me seli në Ferizaj, rr. “Mehdi Xhaferi” duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.100/22 të datës 15.02.2022 të Përmbareuesit Privat Bardh B.Tasholli, jashtë seancës me datën 27.02.2025 mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Elegant” motel – K.M., ashtu që Urdhri Përmbaremore P.nr.100/22, i lejuar me datë 15.02.2022, nga Përmbareuesi Privat Bardh B.Tasholli, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit KRU Bifurkacioni SH.A, me seli në Ferizaj, ka lëshuar urdhrin përmbaremore P.nr.100/22 të datës 15.02.2022, me të cilin ka lejuar përmbareimin, në bazë të ekstraktit të verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit me shifër K026496, duke e obliguar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t’i paguaj kreditorit borxhin prej 5,099.14 €, si dhe të gjitha shpenzimet e përmbareimit. Ndërsa nëse debitori brenda afatit nuk e përmbush detyrimin e lartcekur, përmbareimi të realizohet me ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitori në xhirollogarinë e tij bankare, dhe bartjen e shumës përkatëse në xhirollogarinë bankare të kreditorit, ose me konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, duke theksuar se propozimi për përmbarim është juridikisht jo e rregullt, sipas së cilës përmbaruesi ka lëshuar urdhrin për përmbarim me të cilin ka lejuar përmbarimin e pasurisë së debitorit nuk i plotëson kushtet ligjore me qenë dokument përmbarimor. Më tej ka theksuar se shuma është paushalle pasi që debitori nuk ka qenë fare i lidhur në ujësjellës por është furnizuar me ujë nga bunari. Po ashtu ka shtuar se një pjesë e borxhit është parashkruar. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj në tërësi si të bazuar dhe urdhrin përmbarimor ta shfuqizoj.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pabazuar, duke theksuar se debitori nuk e konteston borxhin e akumuluar. Më tutje ka theksuar se në lidhje me pretendimin e debitorit se i njëjti nuk ka qenë i lidhur në ujësjellës thekson se nga kartela shihet leximi i ujëmatësit, i cili është bërë në mënyrë të rregullt brenda kriteve të parapara ligjore. Po ashtu ka shtuar se pas ankesës së tij në vitin 2012, debitori është faturuar vetëm për kanalizim. Lidhur me pretendimet e debitorit se ka kaluar afati i paraparë për inkasimin e borxhit dhe se i njëjti është parashkruar, një pretendim i tillë nuk është i saktë, ngase debitori në vazhdimësi ka pranuar faturat mujore. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa në par. 2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti – Ekstrakt i verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit me shifër K026496, mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbarim, nuk i

plotëson kushtet e përcaktuara ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas dispozitave të nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të LPP-së, meqenëse në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit, përkatësisht nuk janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i ekstraktit nga librat afariste dhe nuk mund të konstatohet se për cilat periudha kohore është krijuar dhe është kërkuar përmbushja e borxhit nga debitori pasi që në fillimit të ekstraktit debia e regjistruar rezulton se të jetë 413.28 e cila nuk është identifikuar se për cilën periudhë është krijuar.

Prandaj, në formën e paraqitur, ekstrakti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk pasqyron qartë detyrimin që rrjedh nga i njëjti dhe rrjedhimisht nuk përmban atributet e një dokumenti të besueshëm.

Meqenëse gjykata gjeti se dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, nuk u lëshua në vlerësimin e pretendimeve të tjera të ngritura nga debitori si në prapësim, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit vendosi jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm

KPPP.nr.1011/24, datë 27.02.2025

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.